

**Vendim nr. 229 datë 22.09.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                   |           |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Ilir Toska,       | Anëtar    |
| Marjana Semini,   | Anëtare   |

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (Sh) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SHKËLQIM BASHA**, përfaqësuar nga avokat Dritan Kruja, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 9344, datë 29.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1719, datë 15.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-3964 (509), datë 25.09.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**  
**Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 4, 18, 41, 42, 44, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar si mjek imazherist-gjinekolog në spitalin obstetrik gjineokologjik “Koco Glozheni”. Nga vendimet gjyqësore rezulton se ai ka qenë i punësuar, me të njëjtin profesion, edhe në një klinikë mjekësore private që drejtohej nga shtetasja V.P., ku e ka ndjekur klinikisht gjatë shtatzanisë së dytë shtetasen V.B.

2. Në muajin e tretë të shtatzanisë shtetasja V.B. ka kryer vizitën e parë në klinikën private “Moskat” në Tiranë, ku kërkuesi punonte gjithashtu. Në përfundim të kontrollit mjeku ka vlerësuar se shtatzania e shtetasës V.B ishte brenda parametrave normale dhe se fetus i ishte i seksit femër. Pas një muaji nga ekzaminimi i parë mjekësor imazherik (obstetrik/gjinekologjik) dhe nënshtrimit të një sërë analizave, shtetasja V.B. ka kryer sërish vizitë mjekësore, ku kërkuesi i ka bërë të ditur se parametrat ishin normale dhe se në atë moment nuk ishte e domosdoshme bërja e një ekoje tjetër dhe se në javën e 23 të shtatzanisë ishte e rëndësishme të bëhej ekoja morfologjike, nga e cila përcaktohej dhe shikohej qartë, struktura morfologjike e fëmijës, gjymtyrët, organet, tiparet etj. Në datën 24.06.2011, konkretisht në javën e 23-të të shtatzanisë, V.B. ka kryer eko morfologjike në klinikën private të drejtuar nga shtetasja V.P. Në vazhdimësi të shtatzanisë së saj, ajo ka kryer edhe tre eko të tjera morfologjike në këtë klinikë nën kujdesin e kërkuesit, i cili ka vlerësuar sërish se shtatzania e saj ishte normale. Në datën 14.10.2011, e asistuar nga kërkuesi dhe personeli mjekësor, V.B. ka lindur vajzën e saj, F.B., e cila ka rezultuar me anomali fizike, pasi i mungonte tërësisht krahu i majtë.

3. Shtetasja V.B., duke vepruar edhe si përfaqësuese ligjore e fëmijës, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi në kuadër të cenimit të së drejtës për jetë private dhe familjare të parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosinformimit të nënës për mundësinë e lindjes së fëmijës me aftësi të kufizuara “*wrongful life*”. Ajo ka kërkuar nga kërkuesi, në cilësinë e mjekut, dhe shtetasja V.P., në cilësinë e përfaqësueses ligjore të klinikës, shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror si pasojë e gabimit profesional të kryer nga ai, konkretisht moskonstatimin dhe mosinformimin në kohë për anomalinë fizike të vajzës së saj. Me

vendimin nr. 9344, datë 29.09.2014, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e kërkuarit dhe shtetas V.P. t'u paguajnë paditëseve F.B. dhe V.B. shumën 10.000.000 lekë. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuari dhe shtetasja V.P.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1719, datë 15.07.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, detyrimin e shtetas V.P. të dëmshpërblejë paditëset V.B. dhe F.B. në shumën 2.000.000 lekë, si edhe detyrimin e kërkuarit t'i dëmshpërblejë ato në shumën 500.000 lekë. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga palët ndërgjyqëse.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3964 (509), datë 25.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se kjo e fundit e ka zgjidhur çështjen në interpretim të drejtë të ligjit material.

6. Në datën 28.05.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.06.2025, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, më mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

7.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit në datën 25.09.2024, pa prezencën e palëve ndërgjyqëse dhe pa u njoftuar palëve ditën dhe orën e gjykimit të çështjes.

7.1.2. *Parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, në aspektin e zbatimit të ligjit material dhe procedural. Gjykatat e faktit kanë shkelur dispozitat procedurale që rregullojnë mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave. Ato nuk kanë hetuar për marrëdhënien e punësimit të pretenduar midis palëve dhe nuk kanë vërtetuar lidhjen shkakësore materiale mes veprimit të paligjshëm e me faj e dëmit të shkaktuar. Veprimi nuk mund të konsiderohet si mjekim i pakujdesshëm, pasi anomalia nuk është krijuar si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të të paditurit, por ka qenë e lindur, fakt i pranuar edhe nga eksperti i caktuar nga gjykata. Gjykatat nuk kanë analizuar për fazën e shtatzënisë kur mund të identifikohet një e metë e tillë ose faktin nëse prindërit e fëmijës gëzonin të

drejtën absolute të ndërprisnin jetën e fetusit në këtë fazë, edhe nëse anomalia do të ishte konstatuar nga mjeku. Pasaktësitë në vlerësimin e provave, si dhe mangësitë e theksuara në arsyetimin e vendimeve të tyre, për sa i përket përgjegjësisë solidare të të paditurve, masës së dëmshpërblimit, pozitës procedurale të V.P., duke e trajtuar si punëdhënëse të kërkuarit edhe pse nuk ekzistonte asnjë provë që të vërtetonte këtë marrëdhënie, bënin të pamundur marrjen e një vendimi nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në kundërshtim me nenin 424 të Kodit Civil (KC), nuk ka cituar asnjë bazë ligjore për solidaritetin e detyrimit, ndërsa neni 618 i këtij kodi, të cilit ajo i referohet, jo vetëm që nuk parashikon detyrimin solidar të punëdhënësit dhe punëmarrësit përballë personit të dëmtuar, por, përkundrazi, përcakton përgjegjësinë e punëdhënësit për dëmet e shkaktuara nga punëmarrësi ndaj personave të tretë. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë është në kundërshtim edhe me jurisprudencën e konsoliduar të kësaj gjykate, pasi në asnjë rast nuk mund të pranohet përgjegjësia solidare e punëmarrësit me punëdhënësin kur dëmi është shkaktuar nga punëmarrësi, si rezultat i veprimeve të kryera prej tij brenda natyrës së punës së ngarkuar nga punëdhënësi.

7.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* në lidhje me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim. Në dosje gjyqësore nuk ekziston asnjë provë që të vërtetojë ekzistencën e marrëdhënies punëdhënës-punëmarrës ndërmjet shtetases V.P. dhe kërkuarit. Arsyeja e vetme e legjitimitetit pasiv të të paditurve është bërë nga gjykatat për të mbështetur pretendimet e palës paditëse.

7.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar. Ai nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të ngritura lidhur me aktin e ekspertimit të kryer në këtë gjykatë, i cili, edhe pse është administruar në dosjen gjyqësore dhe i është nënshtruar debatit gjyqësor, nuk është analizuar prej saj. Kjo e metë në vendimmarrjen e gjykatës së apelit nuk është konstatuar as nga Gjykata e Lartë, e cila, me një arsyetim formal, ka disponuar me mospranimin e rekursit pa dhënë arsye për të përligjur vendimmarrjen e saj. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk iu ka kthyer përgjigje pretendimeve të ngritura në

rekurs që konsistojn në shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit dhe sigurisë juridike.

- 7.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi është ngarkuar me përgjegjësi më të rënduar, vetëm për shkak të profesionit të tij si mjek, duke aplikuar standarde më të ulëta të provës dhe të përgjegjësisë dhe duke e ngarkuar me përgjegjësi edhe në mungesë të fajit. Kjo formë trajtimi është diskriminuese, pasi çdo profesionist, përfshirë edhe mjekët, kanë të drejtë të gjykohen mbi të njëjtat standarde të përgjegjësisë civile si çdo qytetar tjetër.
- 7.3. *E drejta për një mjet ligjor efektiv*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë ka dështuar të shqyrtojë dhe argumentojë në mënyrë të plotë dhe të drejtë pretendimet thelbësore të ankuesit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitetin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për

mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, me argumentin se është ngarkuar me përgjegjësi më të rënduar, vetëm për shkak të profesionit të tij si mjek, duke aplikuar ndaj tij standarde më të ulëta të provës e duke e ngarkuar me përgjegjësi në mungesë të fajit. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji konstaton se ai është parashtruar drejtpërsëdrejti në ankimin kushtetues individual, pa qenë shteruar më parë mjetet juridike efektive në dispozicion të kërkuetit, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji çmon se kërkuesi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, ndaj nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, referuar shkresës së kësaj gjykate të vënë në dispozicion nga kërkuesi, është bërë i disponueshëm për palët në datën 11.02.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 28.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *së drejtës për mjete ligjore efektive*.

14. Në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar*, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e saj, për shkak se seanca në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit pa prezencën e palëve ndërgjyqëse dhe pa i njoftuar palët për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes.

15. Neni 482 i KPC-së parashikon se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit dhe se, sipas nenit 482/a të këtij kodi,

shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve bëhet në rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj dispozite.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesit i është dhënë mundësia për t’u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar. Përkundrazi, në këto raste debati i palëve realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim, pra përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, propësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura, të cilave Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje, duke vlerësuar shkaqet dhe bazueshmërinë e tyre në themel (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykimi i çështjes nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit është zhvilluar në seancë gjyqësore me dyer të hapura, ku kërkuesi ka pasur mundësinë të marrë pjesë dhe të paraqesë pretendimet e tij për çështjen. Po kështu, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të tij, në të cilin nuk rezultojnë të dhënat e kontaktit elektronik të kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij ligjor. Nga ana tjetër, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 29.07.2024, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, kategoria “Çështje civile”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 25.09.2024, ku pasqyrohet edhe çështja e kërkuesit. Në vijim, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga neni 482, pika 1, i KPC-së dhe, në përfundim të gjykimit, në përputhje me parashikimet e nenit 485, pika 1, shkronja “b”, të këtij kodi, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

18. Për sa më sipër, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, në mungesë të të dhënave të kontaktit elektronik për njoftimin për datën e gjykimit, Gjykata e Lartë ka vepruar me njoftimin e kërkuesit me shpallje në faqen e saj zyrtare, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit që ligji procedural ka përcaktuar, duke i bërë të ditur kërkuesit datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues përkatës. Për më tepër, Kolegji vlerëson se, edhe pse ka barrën e provës, kërkuesi nuk ka arritur të provojë në aspektin kushtetues cenimin e

së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e kësaj forme të gjykimit. Në këtë situatë çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për shkak të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, është haptazi i pabazuar.

19. Për sa i përket *cenimit të parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë* kërkuari ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë shkelur dispozitat procedurale që rregullojnë mënyrën e marrjes dhe të vlerësimit të provave. Sipas tij, pasaktësitë në vlerësimin e provave, si dhe mangësitë e theksuara në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të faktit, kanë bërë të pamundur marrjen e një vendimi nga Gjykata e Lartë.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo Gjykatë mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimin nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard kushtetues, në rastin konkret Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit për vlerësimin e provave nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, ndaj, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve për marrjen e provave, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka arritur të përcaktojë në këndvështrimin kushtetues provat për të cilat ka ngritur pretendime në drejtim të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë së marrjes së tyre. Prandaj edhe nën këtë aspekt ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar cenimin e *parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, me argumentin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është në kundërshtim edhe me jurisprudencën e konsoliduar të kësaj gjykate.

22. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se në materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kërkuari nuk ka paraqitur ndonjë nga praktikat gjyqësore, për të cilat pretendon se nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Për më tepër, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e ligjit, nuk passjell pritshmëri të ligjshme të kërkuarit për zbatimin e tij, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njëses në lidhje me të (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji

vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në këtë drejtim nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuarit kanë të bëjnë, në thelb, me interpretimin që gjykatat i kanë bërë legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin e tij për të paguar dëmin jashtëkontraktor si pasojë e gabimit në moskonstatimin në kohë të anomalisë së foshnjës dhe mosinformimit të nënës, si dhe arsyetimin e tyre në këtë drejtim, Kolegji çmon t'i trajtojë ato në vijim në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

24. Kërkuari ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar, pasi nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të tij për aktin e ekspertimit, i cili nuk është analizuar prej saj. Kjo mangësi procedurale nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, e cila, me një vendim formal për mospranim të rekursit, ka shmangur dhënien e një arsyetimi të plotë dhe të mbështetur në ligj, duke mos iu përgjigjur në mënyrë substanciale pretendimeve të ngritura. Kjo e fundit, në kundërshtim me nenin 424 të KC-së, nuk ka cituar asnjë bazë ligjore për solidaritetin e detyrimit, ndërsa neni 618 i këtij kodi, të cilit ajo i referohet, nuk parashikon detyrimin solidar të punëdhënësit dhe punëmarrësit përballë personit të dëmtuar, por përcakton vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit.

25. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, në rastin konkret Kolegji do të shqyrtojë në vijim nëse gjykatat e zakonshme kanë vepruar në garantim të së drejtës së kërkuesit për të pasur një vendim të arsyetuar, si dhe nëse interpretimi që ato i kanë bërë legjislacionit në fuqi në lidhje me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

28. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se shtetaset F.B. dhe V.B. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të ardhur si rezultat i gabimit profesional të kryer nga i padituri SH.B. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e kërkuesit dhe V.P. t'u paguajnë paditëseve shumën 10.000.000 lekë, për shkak të konsumimit prej tyre të faktit të paligjshëm në të tria elementet objektive dhe subjektive të tij. Sipas gjykatës, kërkuesi, në cilësinë e mjekut, kishte të gjitha mundësitë dhe detyrimin të shikonte anomalinë fizike të fëmijës së paditëses dhe fajësia e tij në ushtrimin e detyrës është konstatuar edhe nga Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili, me vendimin nr. 6, datë 20.06.2012, ka marrë masën “Vërejtje me shkrim dhe paralajmërim për heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit”. Po kështu, përgjegjësi për dëmet e ardhura paditëseve mban edhe klinika, si punëdhënëse e të paditurit në kohën kur ka ndodhur ngjarja, bazuar kjo në nenin 618 të KC-së (*shih faqet 23-26 të vendimit nr. 9344, datë 29.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

29. Gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, gjykata e apelit ka riçelur hetimin gjyqësor, duke caktuar një ekspert tjetër nga ai i gjykatës së rrethit. Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se përgjegjësia për dëmet e ardhura paditëses i mban punëdhënësjë e klinikës mjekësore. Sipas kësaj gjykate, gjatë hetimit ka rezultuar e provuar se në kohën kur ka ndodhur ngjarja kërkuesja ka qenë në rolin e punëdhënëses së të paditurit Sh.B. dhe, bazuar në nenin 618 të KC-së, do të duhet të mbajë përgjegjësi, duke u detyruar t'i dëmshpërblejë ato. Lidhur me masën e dëmshpërblimit, për shkak të shkallës së fajësisë,

shtetasja V.P. detyrohet të paguajë dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar në shumën 2.000.000 lekë, ndërsa kërkuesi në shumën 500.000 lekë (*shih faqen 19 të vendimit nr. 1719, datë 15.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

30. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, me arsyetimin se gjykata më të ulëta kanë provuar plotësisht që janë plotësuar të gjitha elementet thelbësore të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, ndaj në këtë rast gjejnë zbatim rregullimet e përgjithshme të KC-së dhe rregullimet e posaçme të legjislacionit për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara të tretëve nga mjekimi i pakujdesshëm, pasi provohet paligjshmëria e veprimit dhe faji i shkaktuesit të dëmit. Veprimi i kërkuarit është faj për faktin se ka gabuar gjatë ndjekjes së kësaj shtatzanie dhe udhëzimeve dhe informacioneve të specializuara që ai duhej të jepte, pra dëmi ka ardhur si rezultat i mjekimit të pakujdesshëm të tij si mjek imazherist. Nga analiza e provave të administruara në proces ka rezultuar se edhe e paditura V.P., në cilësinë e personit fizik që ushtron aktivitet privat shëndetësor përmes subjektit “klinikë laboratorike”, mban përgjegjësi solidare për dëmin e shkaktuar paditëseve. Gjykata e rrethit ka argumentuar me të drejtë për përgjegjësinë solidare, duke konkluduar se në kushtet që e paditura V.P. ka qenë punëdhënësjë e kërkuarit, ajo, bazuar në nenin 618 të KC-së, mban përgjegjësi në mënyrë solidare me të. Në kushtet kur veprimtaria mjekësore përfshin jo vetëm ofrimin e shërbimeve, por edhe detyrimin për të respektuar standardet profesionale dhe rregullat ligjore në ushtrimin e kësaj veprimtarie, në mënyrë të drejtë gjykata e rrethit ka konstatuar ekzistencën e përgjegjësisë së përbashkët civile të të dy të paditurve, duke urdhëruar shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror që u është shkaktuar paditëseve, si pasojë e këtyre veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme. Sipas gjykatës, organizimi i veprimtarisë mjekësore dhe mënyra e ushtrimit të saj rregullohen nga ligji dhe jo nga kontrata. Prandaj realizimi ose jo i kontratave formale për ofrimin e një shërbimi mjekësor për pacientin nuk afekton mënyrën e realizimit të veprimtarisë mjekësore, e cila ushtrohet sipas dispozitave të ligjit të kohës nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, që rregullojnë këtë veprimtari dhe mungesa e kësaj kontrate formale, ashtu siç ka pretenduar e paditura V.P. në rekursin e saj, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia solidare civile. Detyra e mjekut ka karakter publik dhe rregullohet nga norma juridike të mirëpërcaktuara me karakter detyrues dhe mospërmbushja e saj sipas këtyre rregullave sjell përgjegjësi civile jashtëkontraktore përballë pacientit e të afërmeve të tij (*shih paragrafët 74, 75, 76, 77 dhe 78 të vendimit nr. 00-2024-3964, datë 25.09.2024 të Kolegjit Civil*).

31. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji vëren se, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit për mungesën e përgjegjësisë së tij për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, duke dhënë përgjigje të arsyetuar se, bazuar në parashikimet e KC-së, si dhe rregullimet e posaçme të legjislacionit për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara të tretëve nga mjekimi i pakujdesshëm lidhur me përgjegjësinë e tij, kërkuari, në cilësinë e mjekut, kishte detyrimin dhe mundësitë për të verifikuar anomalinë fizike të fëmijës si dhe të informonte nënën për këtë anomali, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar përfshin edhe klinikën, si punëdhënëse e tij. Ligjshmëria e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta i është nënshtruar në vijim kontrollit të Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka konstatuar shkelje të ligjit material e procedural nga ato gjykata. Në vlerësim të këtyre vendimmarrjeve, Kolegji Civil ka vënë në dukje konkluzionin e arritur nga gjykatat më të ulëta se dëmi është shkaktuar me faj dhe se përcaktimi prej tyre i përgjegjësisë solidarë të kërkuarit si mjek dhe të paditurës V.P si drejtuese e klinikës ku ai ushtronte këtë profesion është e bazuar në dispozitat e përgjithshme të KC-së dhe rregullimet e posaçme të legjislacionit për dëmet jashtëkontraktore, që rregullojnë institutin e dëmit jashtëkontraktor nga mjekimi i pakujdesshëm. Në vlerësimin e Kolegjit, në kundërshtim nga sa kërkuari pretendon, qëndrimet e gjykatave të zakonshme nuk rezultojnë alogjike dhe as arbitrare në aspektin kushtetues, në kuptimin që të bien ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë situatë, në kushtet kur kërkuari ka ushtruar lirisht të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatave, duke marrë përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për shkaqet e përcaktimit të detyrimit solidar të tij në shpërblimin e dëmit, Kolegji çmon se pretendimet për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

32. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.